



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:108951

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792089

C.nr.08/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen kontestimore të paditësve R.V-I, A.H, S.R dhe V.H që të gjithë nga M....., të cilët i përfaqëson Avdi Ademi av në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit-DKA, Baza e kontesti: Kompensim i orëve shtesë, pas arritje se parashtrësës së dt. 06.06.2024 mbi tërheqjen e padisë, jashtë seancës gjyqësore, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e të paditësve R.V-I, A.H, S.R dhe V.H që të gjithë nga M....., të cilët i përfaqëson Avdi Ademi av në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit-DKA, Baza e kontesti: Kompensim i orëve shtesë, **KONSTATOHET E TËRHEQUR**.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes te autorizuarit kanë ushtruar padi me datën 02.04.2024, kundër të paditurës, për Kompensim të orëve shtesë.

Me datën 06.06.2024 pranë kësaj gjykate paditësit ka dorëzuar parashtrësën me të cilën ka deklaruar se e tërheq padinë e ushtruar pranë kësaj gjykate me numër të lëndës C.nr.08.20247 lidhur me Kompensim të orëve shtesë, pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje në procedurë të ndërmjetësimi.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitat e nenit 261 par 3, të LPK-së, i cili nen parashih se “Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia”, e në rastin konkret konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditësve R.V-I, A.H, S.R dhe V.H që të gjithë nga M....., kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit-DKA, Baza e kontesti: Kompensim i orëve shtesë, të **KONSTATOHET E TËRHEQUR**.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 261 par.3 dhe 4, e në lidhje me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.08/2024 dt.06.06.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë në bazë të nenit 261.4 të LPK-së.